



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 63, datë 16.06.2022

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU” TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË ZNJ. FATBARDHA SHEHU

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i proçesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni” dhe Pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë

përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtesë në Aneksin nr. 1, “Pallati nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni” dhe Pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021, përsa i përket klasifikimit si përfituese të znj. Fatbardha Shehu në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 17.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 504 prot.
2

Durrës, më _____, 2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.63 datë 16.06.2022 Për miratimin e një shtese në aneksin nr 1 të VKB Nr 30 dt 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 1032,Rr.”Aleks Komneni” dhe Pall.”Kastrati” Rr.”Ramadan Veliu” të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, duke përfshirë Znj.Fatbardha Shehu

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

